

PËR SHËRBIME POSTARE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR SHËRBIME POSTARE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i ofrimit të shërbimit universal postar dhe shërbimeve tjera postare, mbrojtja e interesave të shfrytëzuesve, sigurimi i trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të tyre, nxitja e konkurrencës së lirë dhe efektive në ofrimin e shërbimeve postare, nxitja e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit dhe sigurimi i sekretit të korrespondencës për shfrytëzuesit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 2 Fusha e zbatimit

Ky ligj rregullon ofrimin e shërbimeve postare, mënyrën e kryerjes së shërbimeve postare, rolin e Qeverisë dhe Rregullatorit në sektorin postar si dhe të drejtat dhe detyrat e operatorëve postar dhe shfrytëzuesve.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

- 1.1. **Shërbim postar** - shërbimet e kryera me pagesë për dërgimin e dërgesave të postës së letrave, pakove, urdhërpagesave si dhe shërbimet e kryera me pagesë të cilat sigurohen nëpërmjet mjeteve për pranimin dhe dërgimin e dërgesave postare;
- 1.2. **Shërbim universal postar** - shërbimet e kryera me pagesë për dërgimin e dërgesave të thjeshta postare deri në dy (2) kg, pakove deri në njëzetë (20) kg, shërbimet e urdhërpagesave dhe shërbimet e veçanta për dërgesat e regjistruara;
- 1.3. **Shërbim i rezervuar** - shërbimet e kryera ekskluzivisht nga Operatori publik postar - Posta e Kosovës;
- 1.4. **Shërbim i veçantë postar** - shërbimet me të cilat dërguesi kërkon mënyrë të veçantë të dërgimit, bartjes dhe dorëzimit të dërgesës;
- 1.5. **Operator publik postar** - person juridik i licencuar për ofrimin e shërbimeve universale postare;
- 1.6. **Operator i shërbimit postar** – person juridik të licencuar për ofrimin e shërbimeve postare;
- 1.7. **Rrjet publik postar** - objektet postare, pajisjet dhe mjetet të cilat janë të lidhura në një proces tekniko-teknologjik, me qëllim të ofrimit të shërbimit postar;
- 1.8. **Zyrë postare** - hapësirën punuese në të cilën operatori postar ofron shërbime postare;

- 1.9. **Agjent postar** - personi fizik ose juridik, të autorizuar për kryerjen e shërbimeve postare nga një operator i shërbimeve postare;
- 1.10. **Kuti postare** - kutit postare të vendosura nga operatori publik postar në vende publike që shërbejnë për pranimin e dërgesave të thjeshta;
- 1.11. **Kuti private postare** - kutia postare e cila shfrytëzohet për dorëzimin e dërgesave postare dhe gjenden në hyrje të ndërtesave ose hyrje të oborreve të shtëpive;
- 1.12. **Shfrytëzuesi** - person fizik ose juridik i cili shfrytëzon shërbimet postare si një dërgues ose marrës;
- 1.13. **Dërguesi** – person fizik ose juridik i cili dërgon dërgesa postare dhe i cili është bartës i të gjitha të drejtave dhe obligimeve nga pranimi deri tek dorëzimi i dërgesës;
- 1.14. **Marrësi** - person fizik ose juridik në të cilin është adresuar dërgesa;
- 1.15. **Taksa postare** – tarifa e caktuar postare për kryerjen e shërbimit postar;
- 1.16. **Licenca** - akti juridik me të cilin operatorit postar i lejohet ofrimi i shërbimeve postare;
- 1.17. **Postë direkte** - një komunikim që ka të bëjë vetëm me material reklame ose marketingu dhe që përmban një mesazh identik, me përjashtim të emrit, adresës apo të dhënave të tjera, të cilat nuk e ndryshojnë natyrën e mesazhit dhe që i dërgohet një numri të madh personash;
- 1.18. **Dërgesë e adresuar** - dërgesa postare në të cilën gjendet adresa e marrësit;
- 1.19. **Dërgesë e postës së letrave** - letra, kartëpostalja, shtypshkrimi, dërgesa për të verbër dhe pako e vogël;
- 1.20. **Dërgesë e thjeshtë** - çdo dërgesë postare që nuk regjistrohet ose shoqërohet me ndonjë shërbim të veçantë;
- 1.21. **Dërgesë e porositur - Rekomande** - dërgesa për të cilën operatori i shërbimit postar i jep dërguesit dëftesën mbi pranimin e dërgesës dhe ia dorëzon marrësit pas konfirmimit me nënshkrimin e tij;
- 1.22. **Dërgesë me Fletëkthesë** - dërgesa për të cilën dërguesi, pas dorëzimit të saj merr konfirmimin – Fletkthesën, në të cilën gjenden të dhënat mbi dorëzimin e dërgesës me nënshkrim të marrësit;
- 1.23. **Dërgesë me kundërpagesë** - dërgesa e cila i dorëzohet marrësit duke arkëtuar paraprakisht shumën e kundërpagesës në dobi të dërguesit të asaj dërgese;
- 1.24. **Shërbimi i Shpejtë Postar (ShShP)** –dërgesa e veçantë urgjente për të cilën dërguesi pranon dëftesën mbi pranimin, dhe i dorëzohet marrësit duke konfirmuar pranimin me nënshkrimin e tij, ndërsa dërguesi përkatësisht marrësi mund të kërkojnë shërbime shtesë, siç është mbikëqyrja e lëvizjes së dërgesës në çdo kohë - online, koha e dorëzimit etj;
- 1.25. **Dërgesë urgjente** - dërgesa e cila përveç shpejtësisë mund të ketë edhe vlerë shtesë me të cilën është përcaktuar në aktet nënligjore për shërbime postare;
- 1.26. **Dërgesa e cila i dorëzohet personalisht marrësit** - dërgesa të cilën operatori i shërbimit postar duhet t'ia dorëzoj personalisht marrësit, përfaqësuesit të tij ligjor, ose personit të autorizuar;
- 1.27. **Dërgesa me vlerë të deklaruar** – letra me vlerë, dërgesën e shërbimit të shpejtë postar ose pakon në të cilën dërguesi deklaron vlerën e përmbajtjes, dhe për humbjen, dëmtimin ose zvogëlimin e përmbajtjes kompensohet deri në shkallën e vlerës së deklaruar të përmbajtjes së dërgesës;

- 1.28. **Dërgesë grupore - Consignment** – dërgimi i një numri të madh të dërgesave nga një dërgues për një ose më tepër marrës;
- 1.29. **Letra** - dërgesa postare e cila përmban komunikatë shkrimi ose gjësende tjera, ku më së shpeshti përdoret për komunikim të ndërsjellë;
- 1.30. **Letra gjyqësore dhe letra me procedurë administrative dhe kundërvajtës** – letra e cila dërgohet nga gjykata ose organet tjera shtetërore për të cilat kërkohet që të bëhet konfirmimi mbi dorëzimin e saj. Letra me përmbajtje gjyqësore mund të jetë e regjistruar dhe urgjente;
- 1.31. **Kartëpostalja** - dërgesa e hapur dhe me tekst e përpunuar nga letra e fortë ose kartoni;
- 1.32. **Sekogrami** - dërgesa postare e cila është e dedikuar për persona të verbër;
- 1.33. **Shtypshkrimi** - dërgesa e hapur që përmban libra, gazeta ose revista. Shtypshkrimi mundë të jetë publikim i lidhur i cili publikohet në treg rregullisht ose kohë pas kohe dhe pa kopertina. Shtypshkrimet të cilat i dërgon dërguesi pa adresa të marrësve konsiderohen shtypshkrime të pa adresuara;
- 1.34. **Pako e vogël** - dërgesa postare të adresuar e cila përmban mall ose sende tjera me peshë deri 2 kg;
- 1.35. **Pako - Koli** - dërgesa e regjistruar e cila përmban mall ose gjësende tjera;
- 1.36. **Urdhërpagesa** - dërgesa me të cilën dërguesi i dërgon marrësit sasi të caktuar të hollash;
- 1.37. **Dëftesa mbi pranimin e dërgesës** - dokumenti të cilin e lëshon operatori i shërbimit postar me rastin e pranimit të dërgesës;
- 1.38. **Pranim i dërgesës postare** - pranimi i dërgesës postare në zyrat e postës, në adresë të dërguesit ose përmes kutive publike postare;
- 1.39. **Makina e Frankimit** - aparati ose pajisja, shenjat e të cilit përdorën për të treguar pagesën e taksës postare. Përmban shenjën operatorit, gjurmët e pullës postare dhe vulës datare postare;
- 1.40. **Aktet e Unionit të Përgjithshëm Postar** - marrëveshjet ndërkombëtare dhe rregullat të cilat i nxjerrin organet e Unionit të Përgjithshëm Postar, kurse aplikohen në shërbimin postar ndërkombëtar;
- 1.41. **Ministri** - Ministrin e Ministrisë kompetente për çështjet e Transportit dhe Postë - Telekomunikacionit;
- 1.42. **Ministria** - Ministria që është kompetente për çështjet e Transportit dhe Postë - Telekomunikacionit;
- 1.43. **Rregullatori** - Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit – ART sipas Ligjit për Telekomunikacion nr. 2002/7.

Neni 4 **Kompetencat e Ministrisë në sektorin postar**

1. Ministria ka kompetencë të
 - 1.1. përcakton strategjinë e zhvillimit të sektorit postar në Republikën e Kosovës.
 - 1.2. përcakton dhe harton politikat e zhvillimit të shërbimit postar dhe siguron kushtet organizative për zbatimin e tyre, duke nxitur investime në sektorin postar;
 - 1.3. ndjek zhvillimin e tregut postar dhe kushtet e ofrimit të shërbimit universal postar;

Created with

- 1.4. bashkërendon veprimtaritë postare me karakter ndërkombëtar.
- 1.5. i propozon Qeverisë strategjinë e zhvillimit të sektorit postar dhe ligjet që rregullojnë veprimtarinë postare;
- 1.6. i propozon Qeverisë masat e nevojshme për të siguruar kryerjen e shërbimeve postare;
- 1.7. nënshkruan marrëveshje me Operatorin publik postar për respektimin e detyrimeve për kryerjen e shërbimeve universale dhe të rezervuara postare;
- 1.8. përfaqëson Ministrinë në organizatat ndërkombëtare postare dhe nënshkruan marrëveshjet në fushën e sektorit postar.

Neni 5

Kompetencat shtesë të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit, përveç kompetencave që ka sipas Ligjit për Telekomunikacion nr. 2002/7, akteve të tjera nënligjore, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe memorandumëve të mirëkuptimit, ku Republika e Kosovës është pjesëmarrëse ose anëtare e saj, ka edhe kompetenca të tjera që i ngarkohen edhe me këtë ligj.

Neni 6

Kompetencat shtesë të Rregullatorit

1. Rregullatori sipas dispozitave të këtij ligji ka kompetencë dhe detyrë:

- 1.1. të formojë sektorin që merret me hulumtimin dhe rregullimin e tregut të shërbimeve postare në territorin e Republikës së Kosovës;
- 1.2. lëshon dhe tërheq licencat operatorëve postarë për ofrimin e shërbimeve universale dhe shërbimeve të tjera postare;
- 1.3. miraton tarifat për shërbimet universale dhe të rezervuara postare, të propozuara nga Operatori publik postar;
- 1.4. përcakton shkallën e peshës - limitin për shërbimet e rezervuara postare;
- 1.5. përcakton tarifat për dhënien e licencave dhe taksën vjetore për ofrimin e shërbimeve postare, si dhe afatet për kryerjen e pagesës;
- 1.6. propozon rregulla Ministrisë për ofrimin dhe përmbushjen e standardeve për realizimin e shërbimeve postare;
- 1.7. mban regjistrin e licencave të lëshuara me të dhënat përkatëse;
- 1.8. mbikëqyrë respektimin e kushteve të përcaktuara me licencë, dhe në rast të shkeljes së kushteve të licencës merr masat e nevojshme ndaj operatorëve postarë;
- 1.9. mbikëqyrë përdorimin e tarifave të shërbimeve postare dhe propozon marrjen e masave ligjore në rastet kur operatori postar nxjerr ose përdor tarifa në kundërshtim me masat e përcaktuara me këtë ligj;
- 1.10. përcjell zhvillimet që kanë të bëjnë me sektorin postar dhe tregun e shërbimeve postare dhe merr masat e nevojshme për të siguruar barazi dhe transparencë për konkurrim në tregun e shërbimeve postare;
- 1.11. zgjedh mosmarrëveshjet në mes të operatorëve postarë dhe shfrytëzuesve me operatorët postarë;

- 1.12. u siguron shfrytëzuesve të shërbimeve postare kushte të barabarta;
- 1.13. mbledh informacionet e nevojshme që kanë të bëjnë me shërbimin postar dhe i publikon ato sipas nevojës;
- 1.14. nxjerr statutin dhe rregulloren e punës;
- 1.15. i dorëzon Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin vjetor të punës;
- 1.16. të kryen edhe punë të tjera në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet e tjera nënligjore.

Neni 7 **Shfrytëzimi i shërbimeve postare**

Të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e huaj që jetojnë në Republikën e Kosovës kanë të drejtë të shfrytëzojnë shërbimet postare, sipas nevojave të tyre dhe në përputhje të plotë me dispozitat e këtij ligji.

Neni 8 **Shërbimi postar ndërkombëtar**

Shërbimi postar ndërkombëtar realizohet në përputhje të plotë me dispozitat e këtij ligji, aktet e Unionit të Përgjithshëm Postar dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me shërbimet postare.

Neni 9 **Dërgesat, veprimtaria dhe shërbimet postare**

1. Dërgesë postare konsiderohet:

- 1.1. letra, kartëpostalja, shtypshkrimi, dërgesa për të verbër - Sekogrami dhe pako e vogël;
- 1.2. pako - kolia;
- 1.3. telefaksi; dhe
- 1.4. urdhërpagesa.

2. Veprimtari postare konsiderohet:

- 2.1. prodhimi, emetimi, vënia në qarkullim dhe tërheqja nga qarkullimi i pullave postare dhe të materialeve të lidhura me to;
- 2.2. pranimi, përpunimi, bartja, dërgimi dhe dorëzimi - shpërndarja e dërgesave postare.

3. Veprimtaritë e përcaktuara në nën-paragrafin 2.1 të këtij neni, do të ushtrohen nga Operatori publik postar me autorizim nga Ministri.

4. Veprimtaritë e përcaktuara në nën-paragrafin 2.2. të këtij neni, ushtrohen në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

5. Veprimtaritë postare të përcaktuara në nën-paragrafin 2.2 të këtij neni, të cilat ushtrohen kundrejt pagesës tarifohen si shërbime postare.

6. Përveç veprimtarive postare të paraqitura në nën-paragrafin 2.2 të këtij neni, Operatori publik postar ushtron edhe veprimtari të tjera, disa prej të cilave kërkojnë licence të veçantë dhe specifike si:

- 6.1. shërbime financiare dhe bankare;

- 6.2. veprimtari sigurimi;
- 6.3. shërbime të transportit - logjistike;
- 6.4. shërbime të tjera;
- 6.5. bashkëpunime me operatorët që ofrojnë shërbime telefonike.

7. Veprimtaritë e sipërpërmendura mund të ushtrohen vetëm nëse ushtrimi i tyre nuk dëmton standardet e ofrimit të shërbimit universal dhe nëse nuk janë në kundërshtim me legjislacionin që rregullon këto shërbime.

Neni 10

Dërgesat postare që ndalohen në shërbimin postar

1. Ndalohet pranimi bartja dhe dërgimi i dërgesave postare të cilat përmbajnë:

- 1.1. lëndë plasëse, që ndezën lehtë, si dhe përmbajtja e të cilave është e rrezikshme;
- 1.2. lëndë helmuese, narkotike dhe psikotrope, lëndë biologjike e radioaktive, sende të turpshme dhe imorale;
- 1.3. kafshë të gjalla përveç kafshëve transporti i të cilave është i përcaktuar me kushte të veçanta për ofrimin e shërbimit postar, dhe
- 1.4. sende të tjera përmbajtja e të cilave është në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Neni 11

Sigurimi i shërbimit universal

1. Ofruesi i shërbimit postar universal, ka për detyrë të ofrojë shërbimet e pranimin, bartjes dhe dorëzimit në trafikun e brendshëm dhe ndërkombëtarë të:

- 1.1. letrës me peshë deri dy (2) kg dhe Sekogramit deri shtatë (7) kg;
- 1.2. pakot – kolidit me peshë deri njëzet (20) kg;
- 1.3. shërbimet e urdhërpagesave dhe
- 1.4. shërbimet e veçanta që kanë të bëjnë me dërgesat nga nën-paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni.

2. Ofruesi i shërbimeve postare ka për detyrë të afrojnë shërbimet e veçanta për pranimin, bartjen dhe dorëzimin e dërgesave me fletëkthesë, dërgesave me kundërpagesë, dërgesave që i dorëzohen personalisht marrësit, dërgesave me paralajmërim, dërgesave me vlerë të deklaruar, dërgesave urgjente, (Shërbimi i Shpejtë Postar - ShShP) dërgesave, dërgesave grupore – (Consignment) dhe dërgesave të tjera të parapara me Rregulloren të shërbimit postar.

3. Shërbimet universale postare duhet të ofrohen në kushte të barabarta për të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve postare në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 12

Shërbimet e rezervuara

1. Operatori publik postar me qëllim të përmbushjes së kërkesave të shërbimit universal postar, ka për detyrë ofrimin edhe të shërbimeve të rezervuara si janë:

- 1.1. pranimin, bartjen dhe dorëzimin e dërgesave të thjeshta me peshë deri një (1) kg;

Created with

1.2. pranimin, bartjen dhe dorëzimin e dërgesave me procedurë gjyqësore, administrative dhe kundërvajtëse;

1.3. prodhimin, emetimin, vënien në qarkullim dhe heqjen nga qarkullimi të pullave postare;

1.4. vendosjen e kutive postare, zbrazjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

2. Shërbimet nga nën-paragrafi 1.1 i këtij neni nuk konsiderohet si shërbime të rezervuara nëse ato kryhen me tarifë më të lartë se trefishi i çmimit bazë.

Neni 13 Shërbimi korrier

1. Operatori i shërbimit postar përmes shërbimit korrier ka për detyrë të afrojë shërbim të shpejtë postar, në bazë të kërkesës së dërguesit, drejtpërdrejt në adresën e marrësit.

2. Shërbimi duhet të realizohet përmes procesit teknologjik që nuk lejohet të ndërpritet me ndonjë aktivitet tjetër, që nga pranimi deri te dorëzimi i dërgesës, duke vepruar në çdo kohë sipas udhëzimeve të dërguesit.

3. Shërbimi korrier sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni siguron bartje të shpejtë dhe të sigurt të dërgesave dhe garanton kohën e dorëzimit, mundësinë e përcjelljes së dërgesave gjatë bartjes dhe veprimet e tjera në bazë të kërkesës së dërguesit, si dhe shërbime të veçanta të cilat i kërkon dërguesi.

4. Shërbim korrier nuk konsiderohen shërbimet e pranimit të dërgesave postare në adresë të dërguesit, të cilat janë të adresuara në adresa të shumë marrësve dhe nuk mund të afrohen sipas mënyrës dhe kushteve të parashikuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Shërbimi korrier ofrohet në tregun e lirë, ndërsa ofruesit e shërbimit postar janë të detyruar që të ofrojnë shërbime postare në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj, dhe akte të tjera ligjore.

Neni 14 Të drejtat dhe detyrat e Operatorit publik

1. Ministria me anë të një marrëveshje autorizon Operatorin publik postar, për të ofruar të gjitha shërbimet universale dhe të rezervuara, përcaktohen të drejtat dhe detyrat e Operatorit publik postar për sigurimin e shërbimit universal postar dhe shërbimet e rezervuara.

2. Marrëveshja lidhet në afat pesëmbëdhjetë (15) vjet dhe duhet të rishikohet çdo pesë (5) vjet, me synimin për të pasqyruar ndryshimet që burojnë nga evoluimi i tregjeve postare dhe i kushteve të përgjithshme.

3. Me marrëveshje rregullohen:

3.1. misioni dhe orientimet strategjike të Operatorit publik postar;

3.2. standardet e realizimit dhe cilësia e ofrimit të shërbimeve postare;

3.3. mënyrat dhe mjetet e kontrollit të kryerjes së shërbimit;

3.4. publikimi i detajeve të shërbimit universal postar për kushtet dhe pikat e qasjes, dëndurisë së zyrave postare për pranimin dhe shpërndarjen e dërgesave postare;

3.5. procedurat e trajtimit të reklamacioneve;

3.6. objektivat financiare dhe treguesit e drejtimit;

- 3.7. parimet e vendosjes së tarifave për shërbimet universale postare dhe shërbimet e rezervuara;
- 3.8. mënyra e mbajtjes së llogarive për të siguruar transparencë;
- 3.9. plani i biznesit;
- 3.10. politika e investimeve dhe ajo kërkimore-shkencore;
- 3.11. politika e zhvillimit të burimeve njerëzore;
- 3.12. kërkesa e bashkëpunimit teknik me ofruesit e tjerë të shërbimeve universale postare, për të siguruar trajtimin jo diskriminues të tyre dhe për shlyerjet e detyrimeve reciproke;
- 3.13. të dhënat statistikore të veprimtarisë dhe periodiciteti i tyre.

Neni 15

Ofrimi i shërbimeve postare nga Operatori Publik

1. Operatori publik postar është i obliguar të ofrojë të gjitha shërbimet universale postare, në bazë të këtij ligji në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Operatori publik postar është i obliguar të siguroj nivel të lartë të cilësisë së ofrimit të shërbimeve universale postare sipas këtij ligji dhe akteve tjera nënligjore.
3. Ministria dhe Operatori publik postar, përfaqësojnë Republikën e Kosovës në Unionin e Përgjithshëm Postar- (UPP).
4. Operatori publik postar është i autorizuar të lidhë marrëveshje dhe kontrata me administratat dhe operatorët tjerë postar për mënyrën, formën dhe kushtet e realizimit të shërbimeve postare.
5. Operatori publik postar është i vetmi i autorizuar të përdor emblemën e postës dhe emërtimin - Postë.

Neni 16

Pulla postare dhe vula datare postare

1. Të gjitha procedurat në lidhje me nxjerrjen, emetimin, vënien në qarkullim, shitjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të pullave postare në Republikën e Kosovës realizohen nga Operatori publik postar.
2. Ministria me akt nënligjor sipas paragrafit 1 të këtij neni përcakton kushtet dhe mënyrën e nxjerrjes dhe përdorimit të pullave postare, si dhe të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pullat postare konform akteve të Unionit të Përgjithshëm Postar.
3. Pulla postare duhet të përdoret për pagesën e taksës postare për dërgesat në komunikacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.
4. Vula datare postare shërben për vulosjen e dërgesave postare, dhe është e parashikuar me aktet të Unionit të Përgjithshëm Postar, dhe aktet për shërbimin universal postar, dhe përdoret vetëm nga Operatori publik postar.
5. Operatori i shërbimit postar mund të përdor edhe vulën nga makina e frankimit, me kusht që në gjurmë të saj duhet të gjendet ora, data, vendi dhe emërtimi i operatorit të shërbimit postar.

Neni 17

Pullat postare të pa vlefshme

1. Pulla postare të pa vlefshme konsiderohen:
 - 1.1. pullat postare të cilat nuk i ka nxjerrë Operatori publik postar;

- 1.2. pullat postare të dëmtuara;
- 1.3. pullat postare të tërhequra nga përdorimi;
- 1.4. pullat postare të vjedhura -inkriminuara;
- 1.5. pullat postare të cilat nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara me aktet e Unionit të Përgjithshëm Postar.

Neni 18 **Bashkëpunimi për realizimin e shërbimit postar**

1. Operatori postar mund të përfitoj nga veprimtaria e një bashkëpunuesi - agjenti postar për kryerjen e shërbimeve që i janë besuar atij.
2. Agjenti postar nuk mund të ushtrojë veprimtari të cilat bien ndesh me kushtet për përmbushjen e veprimtarisë postare.
3. Operatori publik postar përcakton kushtet dhe mënyrën e marrëveshjes me agjentin postar, përdorimin e shprehjes "Postë" dhe për këtë e informon Rregullatorin.

Neni 19 **Informimi për ofrimin e shërbimit postar**

Operatori publik postar dhe operatorët tjerë postar duhet të informojë publikun për shërbimet që i ofrohen, tarifën, orarin e punës dhe standardet e realizimit të shërbimit postar.

Neni 20 **Situatat e jashtëzakonshme**

1. Operatori publik postar duhet të ofrojë shërbime postare, varësisht nga situatat e jashtëzakonshme të krijuara në Republikën e Kosovës.
2. Në kushtet e jashtëzakonshme, të shpallura sipas dispozitave përkatëse ligjore, Ministri me propozim të sektorit postar mund të kufizojë ose pezullojë përkohësisht ofrimin e shërbimit universal postar në hapësirë ose regjion të caktuar.

Neni 21 **Licenca për ofrimin e shërbimeve postare**

1. Për ofrimin e shërbimeve universale dhe shërbimeve tjera postare, personi juridik është i obliguar të pajiset me licencë.
2. Ministria me akt nënligjor përcakton procedurat dhe kushtet për dhënien, pezullimin, revokimin dhe ripërtëritjen e licencave.
3. Licenca lëshohet nga Rregullatori sipas kushteve të parashikuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni i cili duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm për licencim.
4. Rregullatori është i obliguar të shqyrtojë kërkesën nga paragrafi 2 i këtij neni në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e pranimit të kërkesës.
5. Personi juridik i cili është licencuar, është i obliguar të njoftoj Rregullatorin pa vonesë për të gjitha ndryshimet jo më larg se tridhjetë (30) ditë nga dita e aplikimit të atyre ndryshimeve.

Neni 22 **Përmbajtja e licencës**

1. Licenca duhet të përmbajë të dhënat si në vijim:

- 1.1. emërtimi i ofruesit të shërbimeve postare;
- 1.2. shërbimet postare që ofrohen;
- 1.3. territori në të cilin ofrohen shërbimet postare;
- 1.4. adresa e operatorit të shërbimeve postare;
- 1.5. numri i licencës dhe afati i vlefshmërisë;
- 1.6. data e dhënies së licencës.

2. Licenca lëshohet në afat prej dhjetë (10) vite, me mundësi të ripërtëritjes me kërkesë të operatorit të shërbimit postar në mënyrë dhe me kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe akte tjera nënligjore.

3. Operatorit të shërbimit postar nuk i lejohet të transferojë licencën në ndonjë person tjetër juridik.

Neni 23 **Verifikimi i kushteve për dhënien e licencës**

1. Para dhënies së licencës, në bazë të kërkesës me shkrim nga personi juridik, komisioni i emëruar nga Rregullatori bënë verifikimin e kushteve për dhënien e licencës.

2. Komisioni është i obliguar që verifikimin ta bëjë në afat prej tridhjetë (30) ditë nga dita e pranimit të kërkesës.

3. Nëse gjatë verifikimit vërtetohet se aplikuesi nuk i ka plotësuar të gjitha kushtet për dhënien e licencës, komisioni do të marrë vendimin me të cilin do të përcaktohet afati shtesë pesëmbëdhjetë (15) ditë për plotësimin e kushteve.

4. Nëse aplikuesi edhe në afatin shtesë nuk i plotëson kushtet, atëherë Rregullatori do të refuzojë kërkesën për dhënien e licencës.

Neni 24 **Ndryshimet në licencë**

1. Licenca mund të ndryshohet në çdo kohë me kërkesë të operatorit të shërbimit postar ose në bazë të detyrimeve zyrtare.

2. Rregullatori mund të ndryshojë licencën sipas detyrimit zyrtar nëse kjo është e nevojshme për ta harmonizuar me aktet ligjore vendore dhe ndërkombëtare.

Neni 25 **Përfundimi i vlefshmërisë së licencës**

1. Rregullatori merr vendim për përfundimin e vlefshmërisë së licencës në rastet si në vijim:

- 1.1. në bazë të kërkesës me shkrim nga operatori i shërbimit postar;
- 1.2. skadimin e afatit për të cilin është dhënë licenca;
- 1.3. nëse operatori i shërbimit postar nuk fillon me realizimin e shërbimeve postare në afat gjashtë (6) muaj nga dita e marrjes së licencës;

Neni 26 **Taksa Vjetore**

1. Operatorët e shërbimeve postare janë të obliguar të paguajnë taksën vjetore për licencë zyrës së Rregullatorit.

2. Shuma e pagesës, forma, afati kohor dhe çështjet tjera në lidhje me pagesën e taksës vjetore përcaktohen me Vendim nga Rregullatori.

Neni 27 **Kontrolli i operatorëve të shërbimeve postare**

1. Kontrollin e operatorëve të shërbimeve postare, në bazë të këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore, e bënë Rregullatori.
2. Ministria me akt nënligjor përcakton rregullat e detajuara për ushtrimin e kontrollit të operatorëve postar.
3. Operatori i shërbimeve postare është i obliguar që zyrtarit të Rregullatorit, ti mundësoj kontrollin e librave, dokumenteve të ndryshme, pajisjeve, objekteve postare dhe me kërkesë të tij pa vonesë ti vë në dispozicion të gjitha të dhënat e nevojshme që kanë të bëjnë me kontrollin.

Neni 28 **Autorizimet e zyrtarëve të Rregullatorit**

1. Nëse zyrtarët e Rregullatorit gjatë kryerjes së kontrollit, vërtetojnë se operatori i shërbimit postar nuk i kryen shërbimet postare sipas mënyrës dhe rregullave të përcaktuara me këtë ligj, akteve tjera nënligjore, ose nuk siguron funksionimin e shërbimit postar sipas legjislacionit në fuqi, atëherë ai është i autorizuar të:

- 1.1. urdhëroj mënjanimin e të gjitha shkeljeve të vërtetuara sipas paragrafit 1 të këtij neni brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve.
 - 1.2. nëse brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nuk i eliminon në tërësi të gjitha shkeljet e vërtetuara, Rregullatori mund t'i shqiptojë masë gjobe sipas nenit 44 të këtij ligji, me kusht që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve vijuese t'i eliminoi në tërësi të gjitha shkeljet e evidentuara.
 - 1.3. nëse edhe gjatë afatit shtesë prej tridhjetë (30) ditëve nuk eliminohen shkeljet e vërtetuara sipas nën-paragrafit 1.1 dhe 1.2 të këtij neni. Rregullatori ka për detyrë që ta tërheqë licencën.
2. Zyrtarët e Rregullatorit gjatë kontrollit mbajnë procesverbal.

Neni 29 **Zbatimi i vendimit të Rregullatorit**

Kundër vendimit të Rregullatorit lejohet ankesë në pajtim me Ligjin për procedurë administrative, ndërsa pas plotëfuqizimit të vendimit pala e pa kënaqur mund të iniciojë procedurë gjyqësore te gjykata kompetente.

Neni 30 **Pranimi i dërgesave postare**

1. Pranimi i dërgesës postare bëhet në pajtim me kontratën e lidhur ndërmjet Operatorit publik ose privat dhe shfrytëzuesit të shërbimit postar.
2. Vendosja e një dërgese në një kuti postare të instaluar nga Operatori publik postar për këtë qëllim, ose në një pajisje tjetër që i shërben po këtij qëllimi, është e baras vlefshme me pranimin e kësaj dërgese.
3. Pranimi i një dërgese të regjistruar quhet i realizuar nëse dërgesa pranohet nga Operatori publik postar, i cili dërguesit i jep një dëftesë pranimi.

4. Një letër ose pako mund të pranohen me vlerë të deklaruar, vlera e së cilës është e kufizuar në trafikun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, ndërkohë që nëse dërgesa ka si destinacion një shtet të huaj, vlera e deklaruar nuk kalon kufirin e përcaktuar nga vendi i arritjes.

5. Pranimi i urdhërpagesave nga Operatori publik postar bëhet sipas kushteve të përcaktuara me aktet e shërbimit universal postar.

6. Pranimi dhe shpërndarja e dërgesave postare nga operatorët postar bëhet në përputhje të plotë me standardet e parashikuara me direktivat e Bashkimit Evropian:

6.1. koha limit nga pranimi deri në dorëzim, D + 3; 85 % e dërgesave;

6.2. koha limit nga pranimi deri në dorëzim, D + 5; 97 % e dërgesave.

Neni 31

Bartja dhe dërgimi i dërgesave postare

1. Operatorët e shërbimeve postare janë të obliguar që dërgesën postare ta pranojnë, bartin dhe dërgojnë në mënyrë të sigurt deri në destinacion.

2. Operatorët e shërbimeve postare zgjedhin rrugën dhe mënyrën e bartjes së dërgesës deri në destinacion.

Neni 32

Dorëzimi i dërgesave postare

1. Dërgesat postare të pranuar nga operatorët postar duhet t'i dorëzohen marrësit në vendin e treguar nga dërguesi me përjashtim të rasteve kur:

1.1. marrësi mund të autorizojë të tjerët për të pranuar dërgesat postare;

1.2. Operatori publik postar mund t'i dorëzojë një dërgesë të adresuar marrësit nëse dërguesi nuk ka dhënë ndonjë instruksion tjetër, një marrësi zëvendësues - anëtar i familjes ose ta dorëzojë tërthorazi ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

2. Operatori publik postar mund t'i dorëzojë një dërgesë postare në vend të të adresuarit një marrësi të autorizuar - dorëzim tërthorazi, duke shkarkuar përgjegjësinë në adresën e dhënë, nëse ai dorëzim i bëhet:

2.1. njësisë ushtarake;

2.2. entit të vuajtjes së dënimit dhe atyre të edukimit;

2.3. institucionin shëndetësor ose të përkujdesjes sociale;

2.4. hotelit, konviktit të studentëve e të ngjashme.

3. Në vend të adresës së treguar nga dërguesi, një dërgesë mund të kthehet në zyrën e Operatorit publik postar nëse:

3.1. dërguesi ose marrësi kanë dhënë instruksione përkatëse;

3.2. personi i caktuar për të marrë dërgesat nuk është gjetur në adresën e treguar nga dërguesi;

3.3. dorëzimi në adresën e caktuar kufizohet për nga natyra dhe përcaktimet e disa lloje dërgesave.

4. Një dërgesë e thjeshtë mund të dorëzohet, duke e vendosur atë në një kuti private postare në adresën e treguar.

Neni 33

Tarifat e shërbimeve postare

1. Vendosja e tarifave për shërbimet postare përcaktohet duke marrë parasysh kushtet e cekura më poshtë:

1.1. tarifat për shërbimet postare duhet të jenë të arsyeshme dhe të atij niveli që mundësojnë mbulimin e shpenzimeve për ushtrimin e veprimtarisë postare në tërë territorin e Republikës së Kosovës;

1.2. tarifa dhe kushtet e njëjta për tërë territorin e Republikës së Kosovës;

1.3. tarifat duhet të mbulojnë fondin e realizimit të shërbimeve postare dhe mbajtjen e rrjetit të shërbimeve postare;

1.4. tarifat duhet të jenë të përshtatshme dhe të krahasueshme me vendet e Bashkimit Evropian dhe vendet e rajonit.

2. Taksa postare mund të paguhet me pulla postare që janë në qarkullim, me përdorimin e makinës për frankim, me para të gatshme ose mjete tjera ligjore për pagesa.

3. Përdorimi i makinës për frankim rregullohet me kontratë të veçantë të lidhur ndërmjet operatorit publik postar dhe subjektit tjetër përkatës në pajtim me kushtet e përgjithshme për kryerjen e shërbimeve postare.

4. Operatori publik postar për shfrytëzuesit e mëdhenj ka të drejtë të bëjë zbritje nga tarifat bazë të miratuara, duke siguruar transparencë të plotë për të gjithë klientët e interesuar, por kjo nuk mund të përdoret për të diskriminuar klientët e tjerë.

5. Dërgesa për të verbër - Sekogrami, përjashtohet nga tarifat e shërbimit postar.

Neni 34

Rastet kur dërgesa konsiderohet e padorëzueshme

1. Dërgesa postare për të cilën vërtetohet se nuk mund ti dorëzohet marrësit as ti kthehet dërguesit, operatori i shërbimeve postare do ta hap dhe kontrolloj me komision për ta verifikuar adresën e marrësit ose të dërguesit.

2. Në qoftë se edhe pas hapjes dhe kontrollit me komision nuk mund t'i dorëzohet marrësit as t'i kthehet dërguesit, operatori do të:

2.1. asgjësojë me komision dërgesën e thjeshtë (letrën, kartëpostalen, shtypshkrimet etj) nëse ajo përmban vetëm njoftime me shkrim;

2.2. ruaj dërgesat e tjera një (1) vit, duke llogaritur nga data e hapjes dhe kontrollit me komision;

2.3. ruaj tre (3) vjet urdhërpagesën për të cilën vërtetohet se nuk mund të dorëzohet, duke llogaritur nga data kur është vërtetuar pamundësia e dorëzimit të saj.

Neni 35

Bashkëpunimi me doganën

1. Operatori i shërbimeve postare duhet t'i paraqesë autoritetit doganor për kontrollim, në prani të përfaqësuesit të vet dërgesat postare për kontroll doganor.

2. Dërgesat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni që vijnë nga jashtë, duhet të përpunohen nga operatori i shërbimit postar në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse doganore dhe duke u bazuar në marrëveshjen e veçantë me autoritetin doganor.

3. Për dërgesat në shërbimin postar ndërkombëtar, përmbajtja e të cilës duhet ti nënshtrohet kontrollit doganor, duhet të veprohet sipas dispozitave doganore.

Neni 36

Kushtet e kontratës dhe ofrimi i shërbimeve postare

1. Në përputhje me kontratën e shërbimit postar, operatorët e shërbimeve postare janë të detyruar të pranojnë, përpunojnë, dërgojnë dhe të shpërndajnë tek i adresuari çdo dërgesë postare që i përgjigjet kërkesave të paraqitura në dispozitat ligjore përkatëse, standardet dhe aktet tjera të shërbimit postar.

2. Operatori publik postar mund të kundërshtojë plotësimin e kontratës vetëm në rastet e përcaktuara në paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni.

3. Operatori publik postar është i detyruar të refuzojë plotësimin e kontratës për çdo shërbim universal postar nëse:

3.1. shërbimi bie ndesh me kushtet e realizimit të shërbimit universal postar apo me marrëveshjet ndërkombëtare;

3.2. përmbajtja e dërgesës postare nuk është në përputhje me nenin 9 të këtij ligji;

3.3. dërgesa nuk i plotëson specifikimet, të cilat lidhen me dërgesat që i nënshtrohen shpërndarjes së kushtëzuar.

4. Dërgesat postare që përmenden në paragrafin 3 të këtij neni dhe kushtet e pranimit bartjes, dhe dorëzimit të tyre përcaktohen nga Operatori publik postar në aktet e shërbimit universal postar. Gjithashtu, Operatori publik postar merr masat e duhura për publikimin e tyre.

5. Operatori publik postar mund të mos pranojë të lidhë një kontratë nëse:

5.1. ofrimi i shërbimit është pezulluar ose kufizuar në përputhje me nenin 25 të këtij ligji;

5.2. ushtrimi i veprimtarisë nuk përputhet me veprimtarinë e shërbimit postar.

6. Për pranimin e dërgesave me destinacion jashtë kufijve të Republikës së Kosovës, Operatori publik postar është i detyruar të paralajmërojë dërguesin për ndonjë ndalim apo kufizim për importet që është në fuqi në shtetin e arritjes së dërgesës ose në shtetet transite nëpër të cilat dërgesat do të kalojnë.

Neni 37

Përgjegjësia për plotësimin e kontratës së shërbimit postar

1. Operatori i shërbimeve postare mban përgjegjësi për mos përmbushjen e kontratës së shërbimit postar, përfshirë dëmtimin që i është shkaktuar dërgesës, mungesën e përmbajtjes, humbjen si dhe vonesën e dorëzimit të saj, në përputhje me rregullat e shërbimit postar dhe përjashtimet e përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji.

2. Për dëmet e shkaktuara jashtë atyre që janë parashikuar në kontratë dhe për dëmet e shkaktuara nga pakujdesia ose nga ndonjë akt kriminal, Operatori publik postarë mban përgjegjësi në përputhje me dispozitat ligjore dhe masat e dëmshpërblimit.

3. Operatori publik postar mban përgjegjësi vetëm për shumën për të cilën vërtetohet me dëshmi për shërbimin e urdhërpagesave, brenda dhe jashtë vendit.

Neni 38

Rastet e përjashtimit nga përgjegjësia

Created with



nitroPDF[®] professional

download the free trial online at nitropdf.com/professional

1. Operatori publik postarë nuk mban përgjegjësi në fushën e shërbimit postar për:

1.1. dërgesën e thjeshtë postare;

1.2. në qoftë se operatori dëshmon se humbja apo dëmtimi i dërgesës së regjistruar, pakësimi i përmbajtjes ose tejkalimi i afatit për dorëzim është shkaktuar si pasojë e shkaqeve të jashtme ose me faj të dërguesit.

Neni 39 Masat e dëmshpërblimit

1. Operatori publik postar është i detyruar të paguaj dëmshpërblim marrësit përkatësisht dërguesit në rastin e humbjes, dëmtimit ose pakësimit të përmbajtjes dhe tejkalimit të afatit për dorëzimi të:

1.1. dërgesës së porositura dhe pakove pa vlerë të deklaruar;

1.2. letrës me vlerë dhe pakove – kolive me vlerë të deklaruar;

1.3. urdhërpagesave.

2. Në rastin e dërgesave të përcaktuara në nën paragrafin 1.1. masa e dëmshpërblimit bëhet sipas tarifave të miratuara. Në rastin e dërgesave të përcaktuara në nën paragrafin 1.2, dëmshpërblimi do të jetë i barabartë me vlerën deklaruar. Në rastin e dërgesave të përcaktuara në nën paragrafin 1.3. masa e dëmshpërblimit do të jetë e barabartë me vlerën e urdhërpagesës.

3. Për shërbimin ndërkombëtar masa e dëmshpërblimit përcaktohet në përputhje me aktet ndërkombëtare dhe me aktet tjera ligjore për shërbime postare.

Neni 40 Reklamacioni

1. Çdo dërgesë postare e pranuar në zyrat postare me kërkesën e dërguesit përbën çështje reklamacioni. Reklamacionet pranohen për çdo dërgesë postare të pranuar brenda një (1) viti, duke filluar nga dita e nesërme e pranimit të dërgesës postare në zyrat e postës, nëse dërgesa është pranuar për tu dorëzuar në shërbimin e brendshëm, dhe brenda gjashtë (6) muajve duke filluar nga dita e nesërme e pranimit të dërgesës postare nëse dërgesa është pranuar për tu dorëzuar në shërbimin ndërkombëtar.

2. Çdo zyrë e postës është e detyruar të pranojë reklamacionin për dërgesat postare të pranuar në zyrën e sajë ose zyrat tjera postare. Kushtet e detajuara lidhur me reklamacionet përcaktohen me aktet për shërbimin universal postar.

3. Operatori publik postar kërkon pagesën e tarifës postare për shërbim reklamacioni të dërgesës.

Neni 41 Ruajtja e sekretit

1. Ofruesi i shërbimit postar është i obliguar të ruajë sekretin e korrespondencës individuale dhe sekretin e veprimtarisë që i bëhet i njohur gjatë përmbushjes së kontratës.

2. Obligimi i ruajtjes së sekretit është i njëjtë për ofruesin e shërbimit, punonjësit e tij si dhe për çdo njeri tjetër që ka dijeni për sekretin individual ose hollësitë për të cilat ka mësuar gjatë procesit të punës. Nëse zbulohet sekretin e korrespondencës, atëherë personat përgjegjës mbajnë përgjegjësi në përputhje me dispozitat ligjore.

3. Obligimi për ruajtjen e sekretit të korrespondencës, siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të zbatohet edhe pas përfundimit të realizimit të shërbimit postar dhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës ndërmjet punonjësit dhe ofruesit të shërbimit postarë.

Created with

Neni 42 **Mbrojtja e të dhënave**

1. Bazuar në obligimet për ruajtjen e sekretit, operatorit të shërbimit postar me përjashtimet e bëra në rastet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni i ndalohej të:

1.1. hapë një dërgesë postare të mbyllur ose të njihet me përmbajtjen e saj;

1.2. ofroj informata personave të tjerë të dhëna me të cilat ai është njohur gjatë përmbushjes së shërbimit postar, me përjashtim të dërguesit, të adresuarit dhe personit të autorizuar për të marrë ose pranuar dërgesën;

1.3. dorëzoj dërgesën tek personat e tjerë, me qëllim njohjen e përmbajtjes së saj.

2. Operatori i shërbimit postar ka të drejtë të hapë një dërgesë të mbyllur postare me komision ose të shqyrtoj përmbajtjen e saj nëse:

2.1. mungon adresa e marrësit ose dërguesit dhe se dërgesa nuk mund të dorëzohet apo të kthehet, dhe për dorëzimin e saj është e nevojshme të njihet adresa e marrësit ose e dërguesit;

2.2. paketimi i dërgesës është dëmtuar në atë masë që për t'u mbrojtur përmbajtja e saj, është i nevojshëm ripaketimi i cili nuk mund të bëhet pa hapjen e dërgesës.

3. Hapja e një dërgese bëhet duke mbajtur procesverbal për hapjen dhe për masat që duhen marrë. Hapja e dërgesës postare bëhet nga komisioni dhe se për arsyet e hapjes duhet informuar dërguesin ose marrësin.

4. Ndalesat e parashikuara në nën paragrafët 1.1., 1.2. dhe 1.3. të këtij neni, nuk do të zbatohen nëse në bazë të urdhrit të gjyqit veprimet e kryera në to janë të domosdoshme për ndjekjen e një kundërvajtjeje administrative ose veprë penale.

5. Në lidhje me konfiskimin, rezervimin apo sekuestrimin e dërgesave postare do të zbatohen dispozitat ligjore përkatëse.

Neni 43 **Sanksionet**

1. Dënohen si kundërvajtje administrative, aktet e kryera nga një person fizik ose juridik, nëse nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme:

1.1. dërgimi i dërgesave postare pa licencë siç parashikohet me dispozitat e këtij ligji;

1.2. mosrespektimi i kushteve të licencës të parashikuara me këtë ligj;

1.3. shkelja e dispozitave të këtij ligji që kanë të bëjnë me fshehtësinë e korrespondencës, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave;

1.4. mosrespektimi i të drejtës ekskluzive të operatorit publik postar, sipas këtij ligji.

Neni 44 **Gjobat**

1. Kundërvajtjet administrative të parapara në nenin 43 të këtij ligji ndëshkohen me gjobat si në vijim:

1.1. për kundërvajtjet administrative sipas nën-paragrafëve 1.1., 1.3. dhe 1.4. të nenit 43 të këtij ligji në shumën prej pesëmijë (5000) deri dhjetëmijë (10000) Euro;

1.2. për kundërvajtjet administrative sipas nën-paragrafit 1.2., të nenit 43 të këtij ligji në shumën prej njëmijë (1000) deri pesëmijë (5000) Euro.

Created with

2. Dënimin me gjobë sipas nën-paragrafit 1.1 dhe 1.2 të këtij neni e shqipton Rregullatori.
3. Për zbatimin e kërkesave të këtij neni Rregullatorit bashkëpunon me organet përkatëse.
4. Gjobat e shqiptuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, dhe të nën-paragrafit 1.2 të nenit 28 të këtij ligji ekzekutohen nga organi kompetent për pagesë të gjobave për kundërvajtjeve.”
5. Ankesa nuk e shtynë ekzekutimin e vendimit për gjobën.

Neni 45
Mbështetja e Qeverisë

Realizimi i shërbimi universal postar, mbajtja dhe zhvillimi i tyre sigurohen në rast nevojë edhe me mbështetje nga Qeveria përmes subvencioneve.

Neni 46
Bashkëpunimi me organe tjera

Në planet e zhvillimit komunal dhe rajonal, Operatori publik postar bashkëpunon me organet autoritare vendore për krijimin e mundësive për vendosjen e zyrave dhe të pajisjeve që i shërbejnë sigurimit të shërbimeve universale postare, si dhe të lehtësive për përdorimin e hapësirave publike, detyrimin për vendosjen e kutive si dhe administrimin e sistemit të adresave.

Neni 47
Dispozitat përfundimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr. 2003/18 për shërbime postare (Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: Viti II / Nr.19 / 1 dhjetor 2007) si dhe të gjitha dispozitat e tjera ligjore e nën ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 48
Të hyrat

Të hyrat e krijuara sipas këtij ligji inkasohen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 49
Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-173
15 prill 2010

Shpallur me dekretin Nr. DL-017-2010, datë 04.05.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiu.